

Lëshimi i procesverbaleve

Përshkrimi

Lëshimi i procesverbaleve, për të dokumentuar ndodhi apo procese të ndryshme.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Një dokument identifikimi si pasaportë ose kartë identiteti biometrike;
- 2) Paraqitja e të dhënave të nevojshme për ndodhinë apo procesin për të cilin kërkohet procesverbali;
- 3) Paraqitja e dokumenteve mbështetëse për lëshimin e procesverbalit, nëse do të jetë e nevojshme;

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personalisht e personit të interesuar para konsullit ku bëhet verifikimi i identitetit të tij;
- 2) Dorëzimi i mandat-pagesës origjinale të tarifës, që ka derdhur në numrin e llogarisë së përfaqësisë diplomatike ose konsullore të RSH;
- 3) Verifikimi i të dhënave për ndodhinë apo procesin, për të cilin kërkohet dokumentimi me procesverbal;
- 4) Lëshimi i procesverbalit në dy kopje dhe kontrolli me të interesuarin;
- 5) Kopje e procesverbalit mbahet në arkivin e ambasadës apo konsullatës.

Tarifa e shërbimit dhe afati

20 euro ose tarifa ekuivalente në monedhën vendase.

Lëshimi bëhet në momentin që paraqitet i interesuari.

Zyra

Të gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Në rastet kur konsulli nuk është i bindur për rregullshmërinë ligjore të kërkesës për procesverbal të paraqitur, kryhet verifikimi i të dhënave të paraqitura përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Në vendet që nuk ka Ambasadë apo Konsullatë shqiptare, të interesuarit i drejtohen noterëve vendas. Për t'u njohur nga autoritetet në Shqipëri dokumentet e noterëve vendas duhet të legalizohen ose apostilohen, si çdo dokument tjetër i huaj.